

Sihri (magjia)

السحر

< Shqip – Albanian – ألباني >



Abdullah Ahmed El-Huvejl


عبد الله بن أحمد الحويل



Përktheu: Jusuf Kastrati

ترجمة: يوسف كاستراتي

SIHRI (MAGJIA)



Përkufizimi:

Gjuhësisht, fjala arabe *sihër* (سحر), e cila në shqip domethënë *magji* ka kuptimin e *diçkaje, shkaku i së cilës është i fshehtë*.

Ndërsa, në terminologjinë fetare *sihër* quajmë *rukjet, kërkimin e mbrojtjes dhe kurimin me barëra të caktuara që ndikojnë në zemër dhe në trup, me lejen e Allahut*.

Llojet e sihrit (magjisë):

1. Magji që është shirk i madh:

Kjo është magjia që bëhet nëpërmjet xhinëve dhe shejtanëve, të cilët i adhuron magjistari, i bie në sexhde dhe afrohet tek ta për t'ia lëshuar atij të cilit dëshiron t'i bëjë magji.

2. Magji që është *fisk* (فسق) (shmangie nga bindja ndaj Allahut) dhe tejkalim i kufijve:

Kjo është magjia që bëhet përmes barërave të caktuara e të ngjashme me to. Po ashtu edhe fshehja nëpërmjet duarve dhe trukateve të ndryshme.

Vendimi për magjinë:

- Ai që e bën magjinë e llojit të parë bëhet jobesimtar dhe vritet (nga udhëheqësi) si renegat.
- Ai që e bën magjinë e llojit të dytë nuk del nga feja, por numërohet mëkatar i madh. Udhëheqësi mund ta dënojë me vrasje, nëse e sheh të arsyeshme për ta parandaluar të keqen.

Argumenti që dëshmon se magjia është kufër:

Argument për këtë është fjala e Allahut:

﴿ وَمَا يُعَلِّمَانِ مِنْ أَحَدٍ حَتَّى يَقُولَا إِنَّمَا نَحْنُ فِتْنَةٌ فَلَا تَكْفُرْ ﴾

«Këta engjëj nuk i mësonin ndokujt magji, pa i thënë: “Ne jemi dërguar për t’ju vënë në provë, andaj ti mos u bëj mohues (duke mësuar apo ushtruar magjinë)!”»¹

Vendimi për zgjidhjen e magjisë:

Prishja e magjisë bëhet në dy mënyra:

E para: Prishja e magjisë përmes magjisë. Kjo mënyrë është e ndaluar rreptësisht dhe është prej punëve të shejtanit.

E dyta: Prishja e magjisë përmes rukjes, duave të caktuara për mbrojtje nga magjia dhe barërave të lejuara. Kjo mënyrë është e lejuar dhe në të nuk ka asgjë të keqe.

Paralajmërimi nga magjistarët:

Ne duhet t’u tregojmë njerëzve për magjistarët dhe t’i paralajmërojmë nga ata, sepse kjo është pengim nga e keqja dhe këshillim për të mirë.

Shenja nëpërmjet të cilave njihen magjistarët:

Nëse e gjen ndonjërin nga shenjat vijuese të ndonjë mjekues, atëherë dije sigurt se ai është magjistar:

1. E pyet të sëmurin për emrin e tij dhe të nënës së tij.
2. Merr ndonjë gjurmë të të sëmurit (ndonjë rrobë, ndonjë pjesë të këmishës, të fustanit etj.).
3. Shkruan shenja të panjohura.
4. Thotë fjalë të pakuptueshme.
5. Kërkon ndonjë kafshë me veçori të caktuara për ta flijuar pa e përmendur emrin e Allahut gjatë therjes. Mund të ndodhë gjithashtu që ta përlyejë me gjak vendin që i dhemb të sëmurit ose e hedh në ndonjë vend të shkretuar.
6. I jep të sëmurit hajmali, në të cilat ka germa ose numra.
7. Pëshpërit fjalë të panjohura.
8. I jep të sëmurit letra për t’i djegur dhe për t’u tymosur me to.
9. I jep të sëmurit gjëra për t’i futur nën dhe.

¹ Sureja el-bekare, 102.

